



# LISTA POZITIVE

## INPUTE DHE FARERA

**Nr. 5,**  
**Maj 2019**

Miratuar për përdorim në bujqësinë organike në Shqipëri dhe Kosovë, nga  
Komiteti i Listës pozitive të Inputeve dhe Farërave, pranë Albinspekt

## Numrat e publikuar

- ✍ Nr. 1, Mars 2010
- ✍ Nr. 2, Prill 2010
- ✍ Nr. 3, Maj 2011
- ✍ Nr. 4, Mars 2017
- ✍ Nr. 5, Maj 2019

## Ky është numri i pestë, publikuar në Maj 2019

Editori: Albinspekt

Adresa: Rr. Kavajes, Nd. 132, Hy.9, Kati 8, Ap.43, Tiranë, Shqipëri

Tel / Fax: + 355 44806018

E-mail: [contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com)

[www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com)

Listat janë të miratuara nga **Komiteti i Listës Pozitive**, pranë Albinspekt.

**Komiteti i Listës Pozitive** përbëhet nga:

Kristaq Nica, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Dr. Endrit Kullaj, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Prof.As. Abdulla Mani, Mikrobiolog

Prof.As.Dr. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike

Dr. Veis Selami, Albinspekt



Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Sektori i Mbrojtjes së Bimëve: ekspertë të specializuar në fushën e inuteve të përdorura në bujqësi, legjislacionit kombëtar për inputet bujqësore, regjistrimin e inuteve bujqësore të lejuara për përdorim në Shqipëri.



Universiteti Bujqësor i Tiranës: qendra e vetme e formimit universitar, pasuniversitar, kërkimit shkencor, trajnimit dhe e ekstensionit në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, në Shqipëri.



Instituti i Bujqësisë Biologjike: nxit zhvillimin e bujqësisë biologjike, i cili është një sistem miqësor me prodhuesi, knsmatorin, dhe mjedisin. Bujqësi e cila siguron harmonizimin e in teresave të gjeneratave të sotme dhe të ardhme.



Albinspekt: trupë kontrolli e cila siguron një shërbim të plotë në Kontrollin e produkteve organike e sistemeve të cilësisë ushqimore, në përputhje me standardet kombëtare, private e ndërkombëtare.

# Hyrje

Lista Pozitive mbi Inputet dhe Farat e lejuara në Bujqësinë organike gjen zbatim në Shqipëri dhe Kosovë.

Edicioni i listës përmban plehrat dhe produktet e mbrojtjes së bimëve, si dhe sqarimet mbi përdorimin e inputeve dhe farëve, sipas standardet përkatëse. Kjo listë do të azhurnohet vazhdimisht me elementë të tjerë, duke përfshirë përbërësit e lejuar në përpunim, produktet e lejuara për dezinfektim të ndërtesave apo paisjeve bujqësore e agro-përpunuese, etj.

Çdo azhurnim i saj publikohet në edicionin pasardhës dhe në faqen zyrtare të Albinspekt: [www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com)

Lista e Inputeve dhe Farave është detyruese për të gjithë operatorët e certifikuar ose në proces certifikimi nga Albinspekt.

Kjo listë është bazuar në konsultimet me ekspertë shqiptarë të fushës së inputeve dhe farave, institucioneve shtetërore si dhe Institutit të Kërkimit mbi Bujqësinë Organike, FiBL, në Zvicër.

Baza për krijimin e kësaj liste është Standarti Organik Albinspekt (ekuivalnet me Rregulloren e BE EEC 834/2007; Rregullores së BE EEC 834/2007; Ligji shqiptar nr 106/2006, datë 27.10.2016, 'Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre'.

Në këtë listë janë paraqitur referenca mbi Standartin privat zviceran Bio Suisse. Gjithsesi, kjo listë nuk është detyruese për standardin Bio Suisse. Lista e publikuar nga FiBL, Zvicër, së cilës Lista pozitive e Albinspekt i referohet, është e detyrueshme për standardin Bio Suisse.

Lista pozitive është miratuar nga Komiteti i Listës Pozitive, pranë Albinspekt. Ky komitet vepron i pavarur nga Albinspekt dhe përbëhet nga ekspertë të fushës së bujqësisë dhe shëndetit, si përfaqësues të institucioneve prestigjioze në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit.

Tiranë, Maj 2019,

Ekipi i Listës pozitive të inputeve dhe farave



Lista Pozitive është subjekt ndryshimesh, për këtë arsye ju lutem të kontaktoni për versionin më aktual të listës pranë Albinspekt ose vizitoni [www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com)

Për të përfshirë inpute ose fara në Listën Pozitive ju lutem vizitoni [www.albinspekt.com](http://www.albinspekt.com) ose kontaktoni në:



Rr. Kavajes, Nr. 132, Hy. 9, Kati 8, Ap. 43, Tiranë, Shqipëri;



Tel / Fax: + 355 44806018 ;



E-mail: [contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com)

# Përmbajtja

## I. LISTA POZITIVE E INPUTEVE

### **A. Plehrat dhe Pasuruesit e tokës / Fertilizers and soil conditioners**

1. Me origjinë bimore dhe shtazore / Plant & animal origin .....	5
--	---

### **B. Pesticide: Produkte për mbrojtjen e bimëve / Pesticides: Products for plant protection**

1. Substanca me origjinë bimore ose shtazore / Substances of crop or animal origin .....	6
2. Mikroorganizmat e përdorur për luftimin biologjik të dëmtuesve (bakteriet, viruset, dhe kërpudhat) / Microorganisms used for biological pest control .....	7
3. Substancat e prodhuara nga mikroorganizmat / Substances produced by micro-organisms .....	7
4. Substancat për tu përdorur në kurthe dhe/ose shpërndarës / Substances to be used in traps and/or dispensers .....	8
5. Substanca të tjera nga përdorimi tradicional në bujqësinë organike / Other substances from traditional use in organic farming .....	8

## II. LISTA E FARERAVE DHE FIDANEVE .....

11

## III. KOMPANIA PRODHUESE, TREGTUESE OSE IMPORTUESE .....

11

### **Shkurtime**

Në këtë listë janë përdorur shkurtime si më poshtë vijon:

- ▶ Rreg. BE 834/2007—Rregullorja e Bashkimit Evropian EEC 834/2007 mbi bujqësinë organike
- ▶ SOA—Standarti Organik i Albinspekt ekuivalent me Rregulloren e BE-së EEC 834/2007
- ▶ Ligji 106/2016—Ligji shqiptar për bujqësinë organike
- ▶ Bio Suisse—Standart privat zviceran për bujqësinë organike
- ▶ KLPIF—Komiteti i Listës Pozitive të Inputeve dhe Farave pranë Albinspekt

### **Përkufizime**

**Mbarështim intensiv:** sistem bujqësie i industrializuar dhe intensiv në një shkallë të gjerë, i cili fokusohet në përfitimin nga kafshët e mbajtura në sisteme të mbyllura, brenda stallës dhe me lëvizje të kufizuara.

\*Për inputet për përdorim në njësitë që certifikohen sipas standartit privat Bio Suisse, "Lista e Inputeve" publikuar nga FiBL është e detyrueshme për tu zbatuar. Informacion në listën e Albinspekt është vendosur për të orientuar palët e interesuara për ndryshimet midis standarteve të ndryshme.

# I. LISTA POZITIVE E INPUTEVE

## I.A. Plehrat dhe Pasuruesit e tokës / Fertilizers and soil conditioners

### 1. Me origjinë bimore dhe shtazore / Plant & animal origin

Emri tregtar i produktit / Trade name of the product	Përbërja / Content	Kompania prodhuese / tregtuese/ importuese Producer / trader / importer	Standarti / Standard	Vërejtje/shënime mbi përdorimin e produktit / Notes related with the use of the product
PLEH KAFSHËSH	Produkt që përbëhet nga një përzierje e jashtëqitjeve të kafshëve dhe lëndëve bimore (shtresat e fjetjes së kafshëve).		SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Limiti i përdorimit: sasia ekuivalente me <b>170 kg/N/ha</b> në vit. I ndaluar përdorimi i plehut nga mbarështimet intensive
PLEH KAFSHËSH I THARË DHE PLEH PULASH I DEHIDRATUAR			SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Limiti i përdorimit: sasia ekuivalente me <b>170 kg/N/ha</b> në vit. I ndaluar përdorimi i plehut nga mbarështimet intensive
JASHTËQITJET E KOMPOSTUARA TË KAFSHËVE, PËRFSHIRË PLEHUN E KOMPOSTUAR TË PULAVE DHE NGA FERMA			SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Limiti i përdorimit: sasia ekuivalente me <b>170 kg/N/ha</b> në vit. I ndaluar përdorimi i plehut nga mbarështimet intensive
JASHTËQITJET LIKUIDE TË KAFSHËVE (URINË, ETJ)			SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016 Bio Suisse*	I ndaluar përdorimi i plehut nga mbarështimet intensive. Duhet përdorur vetëm pas fermentimit të kontrolluar dhe/ose tretjes së duhur (në ujë).
MBETURINAT SHTËPIAKE TË KOMPOSTUARA OSE TË FERMENTUARA	Maksimumi i përqendrimeve në mg/kg në lëndë të thatë: kadmium: 0.7; bakër: 70; nikel: 25; plumb: 45; zink: 200; mërkur: 0.4; krom (i përgjithshëm): 70; krom (VI): 0		SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016	Produkte të fituara nga mbeturinat shtëpiake të ndara sipas origjinës, të cilat i janë nënshtruar përzierjes ose fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit. Vetëm kur prodhohen nga një sistem grumbullimi të mbyllur dhe të monitoruar, të pranuar nga shteti anëtar.
			Bio Suisse*	Mbeturina organike dhe mbetjet e bimëve, të kompostuara aerobikisht.
TORFË			SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016	përdorim të limituar në hortikulturë (kopshtari, lultari, pentari, fidanishte).
			Bio Suisse	E ndaluar për pasurimin e tokës. Duhet kufizuar përdorimi në fidanëve. Substratet për kërkesat e Bio Suisse nuk duhet të kenë më shumë se 70% torfë dhe nuk duhet të ketë aditivë ose plehra të tjerë të sintetizuar kimikisht.
FERTENAT	Stimulues bimor	Agricultura Moderna Europe shpk	SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016	
COPHYL MAX	Ekstrakt i algës Ascophyllum nodosum	Agrohëlp shpk	SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016	Ushqyes bimor

## I.B. Pesticide: Produkte për mbrojtjen e bimëve

Pesticides: Products for plant protection

### 1. Substanca me originë bimore ose shtazore / Substances of crop or animal origin

Emri tregtar i produktit / Trade name of the product	Përbërja / Content	Kompania prodhuese / tregtuese/importuese Producer / trader / importer	Standarti / Standard	Vërejtje/shënime mbi përdorimin e produktit / Notes related with the use of the product
NEEMAZAL-T/S*				<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Përdorimi vetëm si insekticid</li> <li>✍ Përdoret në tretësirë të 150-250 gr produkt në 100 litra ujë</li> </ul>
OIKOS *	Azadirachtin ekstrakt i <i>Azadirachta indica</i> (Neem) 10g/L		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Mbron bimët nga morrat. Në mollë dëmton morrin miellor që formon frutat e reja dhe gjethet ( <i>Dysaphes</i> sp.). Përdoret para lulëzimit dhe pas lulëzimit. Përsëritet çdo 7-8 ditë. Kufiri i dëmit: 1 % e buqetave gjethore me infeksion me koloni të morrit <b>Kujdes:</b> Disa kultivarë dardhash i djeg
PAREXAN N				
PYRETHRUM FS	Piretrinë ekstraktuar nga <i>Chrysanthemum cinerariaefolium</i>		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid</li> <li>✍ Mos spërkatni në lulëzim</li> </ul>
QUASSAN	Quassia ekstrakt nga <i>Quassia amara</i>		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid, neveritës (repellent)**</li> <li>✍ Përdoret në tretësirë të 20 gr produkt në 100 litra ujë, në sasi 3-4 litra/ ha</li> </ul>
SICID	Rotenon ekstrakt nga <i>Derris spp.</i> and <i>Lonchocarpus spp.</i> and <i>Terphrosia spp</i>		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Insekticid
MICROTHIOL DISPERS	Bakër	Agrohëlp shpk	SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016	Fungicid
OVIPRON TOP	Vaj mineralparafinik	Agrohëlp shpk	SOA (Ekuiv. me Rreg. BE 834/2007) Ligji 106/2016	Insekticid, fungicid

\* Janë të publikuar në Listën e FiBL edicioni i vitit 2009, pra janë të lejuara për përdorim për standardin privat zviceran Bio Suisse.

\*\* Për përdorim në përputhje të plotë me Ligjin 9199, ky produkt nuk duhet përdorur si tërheqës (atraktues) por vetëm si insekticid ose largues.

2. Mikroorganizmat e përdorur për luftimin biologjik të dëmtuesve (bakteriet, viruset, dhe kërpudhat) / Microorganisms used for biological pest control

Emri tregtar i produktit / Trade name of the product	Përbërja / Content	Kompania prodhuese / tregtuese/importuese Producer / trader / importer	Standarti / Standard	Vërejtje/shënime mbi përdorimin e produktit / Notes related with the use of the product
BIONEM WP	Spore të <i>Bacillus Firmus</i>		SOA Rreg. BE 834/2007	Nematocid
			Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Nematocid</li> <li>✍ Vetëm produkte të pamodifikuara gjenetikiisht</li> <li>✍ Përdoret 7-8 kg produkt / dy</li> </ul>
DIPEL SC	<i>Bacillus Thuringiensis</i>		SOA Rreg. BE 834/2007	✍ Insekticid
			Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid</li> <li>✍ Vetëm produkte të pamodifikuara gjenetikiisht</li> <li>✍ Mbron bimët nga larvat e fluturave</li> <li>✍ Përdoret në tretësirë të 600 gr produkt në 100 litra ujë</li> </ul>
DELFIN	<i>Bacillus Thuringiensis</i> var. <i>kurstaki</i>		SOA Rreg. BE 834/2007 Bio Suisse*	✍ Insekticid
			Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid</li> <li>✍ Vetëm produkte të pamodifikuara gjenetikiisht</li> <li>✍ Mbron bimët nga larvat e fluturave. Mbron hardhinë nga tenja (<i>Lobesia botrana</i>) dhe ullirin nga tenja (<i>Prays oleae</i>).</li> <li>✍ Tretësirës i shtohet 1 % sheqer. Përdoret kur larvat janë të reja, në 0.8 kg/ha.</li> </ul>
NOVODOR 3 FC	<i>Bacillus Thuringiensis</i> var. <i>tenebrionis</i>		SOA Rreg. BE 834/2007 Bio Suisse*	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid</li> <li>✍</li> </ul>
			Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid</li> <li>✍ Vetëm produkte të pamodifikuara gjenetikiisht</li> <li>✍ Përdoret në tretësirë të 600 gr produkt në 100 litra ujë</li> </ul>

3. Substancat e prodhuara nga mikroorganizmat / Substances produced by micro-organisms

Emri tregtar i produktit	Përbërja	Kompania prodhuese / tregtuese/importuese	Standarti	Vërejtje/shënime mbi përdorimin e produktit
SPY	Spinosad		SOA Rreg. BE 834/2007 Bio Suisse*	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Insekticid</li> <li>✍ Vetëm kur merren masa që minimizojnë rrezikun për parazitët kryesorë dhe minimizojnë rrezikun e zhvillimit të rezistencës</li> </ul>
AUDIENZ				
SPINTOR				

4. Substancat për t'u përdorur në kurthe dhe/ose shpërndarës / Substances to be used in traps and/or dispensers

Emri tregtar i produktit / Trade name of the product	Përbërja / Content	Kompania prodhuese / tregtuese/importuese / Producer / trader / importer	Standarti / Standard	Vërejtje/shënime mbi përdorimin e produktit / Notes related with the use of the product
DAP	Diamon fosfati		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	Tërheqës, vetëm për përdorim në kurthe
ECHO - TRAP RB	Ferromone		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Tërheqës; konfuziv.</li> <li>✍ Vetëm për përdorim në kurthe dhe shpërndarës</li> </ul>
ISOMATE - C Plus	Ferromone		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Tërheqës; konfuziv.</li> <li>✍ Vetëm për përdorim në kurthe dhe shpërndarës</li> <li>✍ Mbron frutat e mollës nga krimbi mollës (Cydia pomonella)</li> <li>✍ Blloku trajtuar duhet të jetë 200-300 metra nga blloqet fqinjë të pa trajtuara.</li> </ul>
ISONET-L	Ferromone		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Tërheqës; konfuziv.</li> <li>✍ Vetëm për përdorim në kurthe dhe shpërndarës</li> <li>✍ Përdoret 500 copë për ha</li> </ul>
OLIVE FLY ATTRACT & KILL	Lambda Cyhalothrin		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Vetëm për përdorim në kurthe me tërheqës specifikë; vetëm për përdorim ndaj <i>Bactrocera oleae</i> dhe <i>Ceratitis capitata</i> .



5. Substanca të tjera nga përdorimi tradicional në bujqësinë organike / Other substances from traditional use in organic farming

Emri tregtar i produktit / Trade name of the product	Përbërja / Content	Kompania prodhuese / tregtuese/Importuese Producer / trader / importer	Standarti / Standard	Vërejtje/shënime mbi përdorimin e produktit / Notes related with the use of the product
CHAMP FORMULA 2	Hidroksid Bakri Cu(OH) <sub>2</sub>		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Vetëm si fungicid</li> <li>✍ Mbron bimët nga vruçu, kroma e mollës, antraknozot në perime, syri i palloit në ullishte, veprim mesatar për bakteriozat duke përfshirë edhe mbrojtjen mollës nga zjarri bakterial (<i>E. amylovora</i>)</li> <li>✍ Përdoret në tretësirë 200 gr produkt në 100 litra ujë</li> </ul>
CHAMPION 50 DF				
CHAMPION WP				
COPROXIDE				
HIDROXID Cu				
KENTAN WG				
KOCIDE 101 50 WP				
KOCIDE 2000				
PARASOL				
IRAM				
CUPROXAT LIQUIDE LG	Sulfat Bakri (tribazik)		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016 Bio Suisse*	Vetëm si fungicid
GURE KALI	Sulfat Bakri		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Vetëm si fungicid</li> <li>✍ Vetëm në formë tretësire, kur është i përzier me gëlqere të shuar e ujë</li> <li>✍ Mbron bimët nga vruçu, kroma e mollës, antraknozot në perime, syri i palloit në ullishte, veprim mesatar për bakteriozat duke përfshirë edhe mbrojtjen mollës nga zjarri bakterial</li> </ul>
COUPROL 50 WP	Oksiklorur Bakri ClCu <sub>2</sub> H <sub>3</sub> O <sub>3</sub>		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	Vetëm si fungicid
GYPSO GD				
NEORAM WG				
RAME 40 % WG				
ZETARAM 20 L				
BIOLIDE E	Vaj mineral		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	Insekticid, fungicid; Vetëm në pemë frutore, vresht, ulli dhe kultura tropikale (psh. banane)
POLITHIOL				
KUMULUS WG	Squfur		SOA Rreg. BE 834/2007 Ligji 106/2016	<ul style="list-style-type: none"> <li>✍ Fungicid, akaricid, largues (repellent)</li> <li>✍ Mbron bimët nga sëmundjet e hireve. Jep efekt të mirë anësor për këpushat eriofida që janë në formë kribmi. Dozat e larta në pranverë. Përdoret mbi 12° C. Në verë mund të shkaktojë njolla mbi fruta, kur dozat kalohen</li> <li>✍ Përdoret në tretësirë 200-600 gr produkt në 100 litra ujë</li> </ul>
DISPERSS				
SPECIAL DISPERSS				
MICROTHIOL				
SULPHUR 80 WG				

## INFORMACION

### Për përdorimin e Bakrit në bujqësinë organike duhet të keni parasysh sa më poshtë, si parime të përgjithshme:

Bakri i lejuar për përdorim në bujqësinë organike është vetëm Bakër në formën e:

- ✓ Hidroksidit,
- ✓ Oksiklorurit,
- ✓ Sulfatit trebazik,
- ✓ Oksidit, dhe
- ✓ Bakër oktanoat (sapun) .



**Kujdes:** përdorimi i bakrit sipas rregulloreve të ndryshme ka kufizime për sasinë e bakrit të pastër për HA në vit.

i. Sipas Rregullores së BE 834/ 2007 dhe Standartit Organik të Albinspekt, bakri mund të përdoret **vetëm si fungicid**; dhe në këto sasi:

- ✓ përdorim deri në **6 kg bakër i pastër për ha për vit**;
  - ✍ shmangie për bimët shumëvjeçare: mund të kalohet kufiri prej 6 kg Cu/ha/vit, në një vit të caktuar, nëse sasia mesatare e përdorur në një periudhë prej 5 vjetësh, duke llogaritur 4 vitet përpara këtij viti dhe vetë këtë vit, *nuk e kalon 6 kg/ha/vit.*

ii. Sipas Standarteve të Bio Suisse, bakri mund të përdoret në këto sasi:

- ✓ Përdorimi përgjithshëm, deri në **4 kg bakër i pastër për ha për vit**; nëse kjo sasi kalohet, duhet njoftuar trupa certifikuese.
- ✓ Përdorim specifik:
  - Perimet, patatet, vresht, dhe frutat bërthamorë – deri në 4 kg;
  - Manoret – deri në 2 kg; dhe
  - Frutat farore – deri në 1.5 kg.

iii. Sipas Ligjit 106/2016, përdorimi i bakrit:

- ✓ Duhet të jetë vetëm si fungicid, dhe
- ✓ Preparati i bakrit duhet të njihet nga organizmi certifikues.

## II. LISTA E FARERAVE DHE FIDANEVE / List of seeds and seedlings

Emri i kulturës (shqip) / Albanian name of species	Emri i kulturës (latinisht) / Latin name of species	Klasifikimi i bimës (nëngrupi i kulturës) / Classification of the plant	Cilësia (organike, konvencionale) / Quality (organic, con- ventional)	Standardi (çertifikuar sipas) / Standard (certified according to)	Data e vlefshmërisë / Validity	Kompania prodhuese / tregtuese/ importuese / Producer, trader, importer
--	---	---	--	---	--------------------------------------	--

Nuk ka farëra apo fidanë organik në Shqipëri dhe Kosovë. Mundësia e gjendjes së farave organike në tregun ndërkombëtar mund të kontrollohet gjithashtu në linkun [www.organicxseeds.com](http://www.organicxseeds.com)

There are no organic seeds and seedling available in Albania and Kosovo. The availability of organic seeds in the international market can be also checked in the following link: [www.organicxseeds.com](http://www.organicxseeds.com)

## III.KOMPANIA PRODHUESE, TREGTUESE OSE IMPORTUESE / PRODUCERS, TRADERS OR IMPORTERS

Emri i kompanisë / Name of the company	Adresa / Address	Kontaktet / Contacts
<b>Agrohëlp shpk</b>	L.Nr.1, Rr. A. Durrsaku, Nr. 1076, Durrës, Shqipëri	www.agrohëlp.al akolaci@abcom-al.com



Referenca për identifikimin e inputeve dhe farërave të përfshira në Listën Pozitive



## Reklama Juaj

Kontaktoni:

Tel / Fax: + 355 44806018

E-mail: [contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com)